



Pranuar / Dostiguar Prilidheni / Prilidato Received / Delivery	24.01.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSICK	796/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1124/2022

~~Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1124/2022 të datës 09.12.2022 të parashtruar nga ankuesja~~

kundër Vendimit me Nr.1734/2022 të datës 11.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1141/2022 e datës 09.12.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 1734/2022 i datës 11.11.2022 i Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 09.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7822/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.1734/2022 të datës 11.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me pretendimet për shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 28.12.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7822/2022 të datës 09.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot:1734/2022 i datës 11.11.2022 i Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin e Këshillit A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022; Fletë kthesat e datës 17.10.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.12.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 28.12.2022; Akt emërimit ankueses të datës 01.02.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Departamentit për Përkrahjen e Investimeve të Diasporës; Raportin e Komisionit të ri-strukturimit i datës 01.11.2022 me numër:1620; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa/ZKF"; Konkursin e datës 18.01.2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Drejtor i Arkivit Ndër komunal në Prishtinë"; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut"; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Zhvillim dhe Koordinimin e Nismave Rajonale"; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Drejtorisë së Administratës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës"; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore"; Vendimin e datës 16.03.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me listën e pozitave të aprovuara; E-mailin e datës 27.10.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së për stafin; E-mailin e datës 28.10.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së për stafin lidhur me vazhdimin e afateve për preferenca të pozitave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, **SEPSE**:

Nga vlerësimi i provave të lëndës rezulton së më Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe si rrjedhojë si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës.

Me tej, nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022 të Zëvendësueses së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (tutje DMZP-ja) është themeluar Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPJD ka njoftuar individualisht ankuesen së në rastin konkret të ristrukturimit do të aplikohen dispozitat e nenit 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka gjetur se ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 01.02.2019 ka qenë e punësuar në pozitën *Drejtoreshë e Departamentit për*

Hulumtime dhe Përkrahjen e Investimeve të Diasporës në Ministrinë e Diasporës, ndërsa sipas Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kjo pozitë nuk është paraparë. Meqenëse pozita që ka mbajtur ankuesja ka pësuar ndryshime, ndërsa sa i përket kualifikimeve të posaçme respektivisht njohjes së gjuhës së huaj, Komisioni i Ristrukturimit nuk ka mund të emëroj ankuesin në një pozitën të kategorisë së njëjtë brenda ministrisë për arsye se e njëjta nuk ka plotësuar kushtet e posaçme për pozitën e lira përkatëse, ndërsa është rekomanduar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë transferimin në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Ankuesja më datë 10.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Vendimit me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen e ankuesit.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas vendimit të Këshillit me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, ka shqyrtuar çështjen e rastit të ankueses dhe në bazë të Raportit të veçantë të punës me numër protokollit 1620 të datës 01.11.2022, ka konstatuar se ankuesja nuk mund të sistemohet përkatësisht të transferohet në ndonjë pozitë të lirë brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak që nuk ka plotësuar kushtet e pozitave, respektivisht kushtet e posaçme formale, duke i propozuar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike që e njëjta të transferohet në pozitën Drejtor i Arkivit Ndër komunal në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 11.11.2022 ka nxjerr Vendim me Nr.prot:1734/2022 përmes të cilit ankuesen e ka transferuar në pozitën Drejtor i Arkivit Ndër komunal në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr. prot: 1743/2022 të datës 11.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pretendon se procedura e transferimit është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, sepse nuk janë plotësuar kushtet për ristrukturimin e pozitës së ankueses, respektivisht ndryshimi i kualifikimeve të posaçme është bërë qëllimshëm në dëm të ankueses, ngase gjuhë zyrtare janë vetëm gjuha shqipe dhe serbe dhe se caktimi i kriterëve për njohje të gjuhëve të tjera nuk është i drejtë, sikurse koeficienti i pagës është 9.5 apo më i ultë se pozita të cilën e kam ushtruar sipas aktit të emërimit.

Kolegji i Këshillit, fillimisht ka shqyrtuar pozitën e kategorisë së mesme drejtuese që janë të lira në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të cilat janë: *Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate; Drejtor i Departamentit për Diplomaci Publike, Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë, Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare dhe Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit*, dhe ka konstatuar që për pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: *“Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i*

akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze”, për pozitën Drejtor i Departamentit për Diplomaci Publike tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: “Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze”, për pozitën Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: “Njohje e gjuhës angleze ose gjuhën frënge e në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose gjuhën frënge, ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze ose gjuhën frënge”, për pozitën Drejtor i Departamentit për Organizatat Ndërkombëtare tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: “Njohje e ndonjë prej (6) gjuhëve zyrtare të OKB-së, në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura”, dhe për pozitën Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit, tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: “Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura”. Kolegji nga këto rrethana, konstaton se ankuesi nuk ka plotësuar kushtet e posaçme formale për këto pozita duke mos ofruar dëshmi relevante për këtë, kështu që ankuesi nuk mund të argumentoj me asnjë provë që ndryshimi i kualifikimeve të posaçme është bërë me qëllim të dëmtimit të tij, sepse ky përshkrim është i miratuar, andaj edhe pretendimi i tij është i pabazuar.

Lidhur me pretendimet ankueses se gjuha zyrtarë në Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe, vlerëson se këto pretendime janë të paqëndrueshme në rastin konkret, ngase pozitat e lira në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të cilat janë evidentuar si lartë, janë pozita të punës të cilat kanë ndërlidhje bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe për ushtrimin e detyrave funksionale është e nevojshme njohja e gjuhëve të huaja, gjegjësisht gjuhët të cilat në ato organizata llogariten gjuhë zyrtare, sikurse edhe tek bashkëpunimeve protokollare më delegacione zyrtare të shteteve të ndryshme, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton faktin se këto pretendime të palës ankuese janë të bazuara dhe nuk mund të gjejnë aplikim apo zbatueshmëri në rastin konkret.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë për objekt çështjen të koeficientit të pagës, thekson faktin së Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hynë në fuqi një (1) muaj pas publikimit në gazetë zyrtare. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarëve në sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave. Ndërsa është për tu theksuar fakti se pozita në të cilën është transferuar ankuesja sikurse edhe pozita të cilën e ka ushtruar sipas aktit të emërimit të datës 01.02.2019 janë pozita të së njëjtës kategori në kuadër të shërbimit civil.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Qeveria ka qenë e obliguar që të nxjerr e nënligjore me qëllim të zbatimit të këtij ligji, ndërsa në rastin konkret për procedurat e

transferimit Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Rregulloren Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, e cila në mënyrë më të hollësishme përcakton procedurat e transferimit të nëpunësve civil në këtë rast edhe procedurën e transferimit me rastin e shuarjes apo ristrukturimit të institucioneve, rrjedhimisht Komisioni i Ristrukturimit me rastin e përgatitjes së raportit me numër protokolli 1620 të datës 01.11.2022 askund si bazë nuk ka marrë Udhëzuesin Nr. 02/2022 për Procesin e Riorganizimi të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve Civil pas Ristrukturimit, mirëpo sipas Kolegjit të Këshillit, ky udhëzues ka karakter që të pasqyrojmë metodologjinë që do ta përdor Komisioni i Ristrukturimit në institucionet ku ka ristrukturim, pasi që Rregullorja Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil nuk ka ndonjë mekanizëm lidhur me metodologjinë se si duhet të punoj Komisioni i Ristrukturimit, po ashtu ky udhëzues i ka paraparë të gjitha hapat procedural sikurse edhe rregullorja përkatëse.

Nga të cekurat si më lartë është konstatuar se pozita e ankuesit që ka mbajtur brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka pasur ndryshime në emërtim po ashtu edhe në kriteret respektivisht kualifikimet e posaçme, atëherë në këtë rast Kolegji i Këshillit ju referuar nenit 13 paragrafi 1 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës"*, ndërsa, pas ristrukturimit Komisioni i Ristrukturimit ka bërë përpjekjet maksimale që ankuesi të sistemohet brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, por meqë i njëjti nuk ka plotësuar kushtet konkretisht kualifikimet e posaçme për asnjë nga pozitat e nivelit të mesëm drejtues atëherë mundësia e vetme ka qenë propozimi për transferim në një pozitë të kategorisë së njëjtë në një institucion tjetër të shërbimit civil, ashtu siç parashihet edhe me nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil"*. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni i Ristrukturimit me rastin e përgatitjes së raportit me numër protokolli:1620 të datës 01.11.2022 për rastin e ankuesit dhe propozimin për transferimin e ankueses, ka vepruar në pajtim me kompetencat e përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr.1734/2022 të datës 11.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme përmes të cilit ankuesja është transferuar në pozitën Drejtor i Arkivit Ndër komunal në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ka konstatuar se ky vendim është nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, duke marr parasysh që përveç tjerash ankuesi posedon përgatitje profesionale në fushën në të cilën kërkohet për pozitën përkatëse ku është transferuar, andaj pretendimet e ankuesit ndaj këtij vendimi janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.1124/2022**

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Boshkëpunim Profesional



Estref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

